

LIGJ
Nr.9372, datë 14.4.2005

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.7971, DATË 26.7.1995
“PËR PROKURIMIN PUBLIK”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, indryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 5 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“5. Enti prokurues, për objekte të mëdha publike dhe për shërbime, kur afati kohor i ndërtimit dhe i investimit të tyre kërkon vazhdimin edhe në vitet kalendarike pasardhëse, prokuron fondet për ndërtimet, shërbimet dhe supervizionin e tyre, sipas vlerës së plotë të objektit të prokurimit. Çdo objekt i prokuruar për vlerën e plotë, i shtrirë në më shumë se një vit kalendarik, detyrimisht përfshihet në buxhetet e viteve pasardhëse, për vazhdimin dhe përfundimin e tij.”.

Neni 2

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“a) kur në mungesë të konkurrencës, për arsye teknike, mallrat, ndërtimet ose shërbimet sigurohen vetëm nga një kandidat;”.

2. Pas shkronjës “f” shtohen shkronjat “g” dhe “gj” me këtë përmbajtje:

“g) për investime, projekte dhe sisteme të teknologjisë së informacionit, që lidhen drejtpërdrejt me çështjen e sigurisë në burgje;

gj) kur një furnizues ose kontraktues ka të drejtën ekskluzive për mallrat, për ndërtimet ose për shërbimet.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4550, datë 29.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu